



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Treguesit Statistikor të Tregut të Komunikimeve Elektronike

Tremujori IV 2020

Data e Publikimit: 03.03.2021

INDEKSI I PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	3
II.	TENDENCAT KRYESORE.....	4
III.	TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET CELULARE.....	6
IV.	TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET FIKSE	12

INDEKSI I TABELAVE

TABELA 3.1 :	NUMRI I PAJTIMTARËVE/PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KATEGORIVE	6
TABELA 3.2:	NUMRI I PAJTIMTARËVE TË SHËRBIMEVE CELULARË (KARTA SIM) SIPAS OPERATORËVE.....	7
TABELA 3.3:	NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË SHËRBIMEVE CELULARE SIPAS OPERATORËVE..	7
TABELA 3.4:	NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË TELEFONISË CELULARE SIPAS OPERATORËVE ...	8
TABELA 3.5:	NUMRI I PËRDORUESVE TË AKSES BROADBAND NE RRJETET 3G/4G SIPAS OPERATORËVE.....	8
TABELA 3.6:	VOLUMI TOTAL I THIRRJEVE, SMS-VE, TË DHENA DHE PERDORIMI MESATAR MUJOR.....	9
TABELA 3.7:	STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE TE ORIGJINUAR BRENDA VENDIT SIPAS DESTINACIONIT	11
TABELA 4.1 :	NUMRI I LINJAVE TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE	12
TABELA 4.2 :	NUMRI I PAJTIMTAREVE ME AKSES BROADBAND NGA RRJETET FIKSE	12
TABELA 4.3 :	NUMRI I PAJTIMTAREVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA	12

I. Hyrje

Bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe Rregullores nr.12, datë 07.04.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar, AKEP mbledh të dhëna periodike statistikore nga sipërmarrësit ofrues të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

AKEP ka filluar të publikojë periodikisht të dhëna dhe tregues statistikorë të tregut të komunikimeve elektronike prej muajit Prill 2009 në faqen web www.akep.al. Periodiciteti i publikimeve dhe treguesit e publikuar kanë evoluar nga raportime vjetore dhe gjashtëmujore në raportime vjetore dhe tremujore duke filluar nga Tremujori 4 2014.

Sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrim ligjor të dërgojnë në AKEP, të raportojnë të dhëna periodike rreth aktivitetit të tyre sipas formularëve përkatës që janë pjesë e Rregullores Nr.12. Informacioni i kërkuar nga AKEP nëpërmjet formularëve të Rregullores shërben për përmbushjen e detyrave funksionale të AKEP, ndër të tjera edhe për publikimin e treguesve për publikun e gjerë nëpërmjet raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike.

AKEP publikon treguesit kryesorë të tregut të komunikimeve elektronike duke marrë në konsideratë si natyrën konfidenciale të një sërë treguesve të raportuar nga sipërmarrësit edhe interesat e publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues. Për këtë arsye shumë tregues paraqiten të agreguar për tregun në tërësi dhe jo sipas operatorëve, ndërsa disa tregues paraqiten edhe sipas operatorëve.

AKEP mundohet që të dhënat e publikuara të jenë të plota dhe të sakta për të garantuar një pasqyrim të drejtë të situatës dhe tendencave të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Megjithatë, në disa raste informacioni i mbledhur mund të mos jetë i plotë për shkak se jo të gjithë sipërmarrësit raportojnë në kohë dhe me cilësinë e duhur të dhënat e kërkuara.

AKEP për të rritur plotësinë dhe saktësinë e informacionit të mbledhur dhe të publikuar bashkëpunon me operatorët gjatë procesit të raportimit të të dhënave nëpërmjet komunikimit në modulën on-line, e-mail dhe telefon, si dhe përdor mekanizmat ligjorë të detyrimit të raportimit të të dhënave si inspektime në terren dhe/ose vendosjen e sanksioneve ligjore për mos-raportim të të dhënave.

Për të rritur cilësinë e informacionit të publikuar si dhe krahasueshmërinë me periudhat e mëparshme, AKEP në disa raste përfshin vlerësime të numrit të pajtimtarëve për operatorët (kryesisht operatorë të vegjël të rrjeteve fikse) që nuk kanë raportuar në periudhën përkatëse duke përdorur numrin e pajtimtarëve të raportuar në periudhat e mëparshme të këtyre operatorëve. Gjithashtu në disa raste AKEP mund të publikojë rishikim të treguesve të publikuar për periudhat e mëparshme për shkak të ndryshimeve të vlerësimeve dhe/ose metodologjisë së përdorur nga AKEP dhe/ose raportimeve të operatorëve. Të tilla raste evidentohen nëpërmjet shënimeve përkatëse të AKEP në publikimin më të fundit të të dhënave/informacionit të tregut.

Të dhënat dhe treguesit e publikuar në këtë raport janë për pesë tremujorët e fundit, si dhe të dhëna vjetore për dy vitet para-ardhëse. Për periudhat më të hershme lexuesi mund t’i referohet publikimeve të mëparshme të AKEP. Norma e ndryshimit të një treguesi me tremujorin para-ardhës paraqitet si ***‘Ndryshimi Tremujor’***, ndërsa norma e ndryshimit në terma vjetorë (me të njëjtin tremujor në vitin para-ardhës) paraqitet si ***‘Ndryshimi v-m-v’***.

Për shkak të rrumbullakimeve të vlerave në disa raste mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për tregues të caktuar.

Në Tremujorin e katërt 2020 kanë raportuar rreth 193 sipërmarrës të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ndërsa për Tremujorin e tretë 2020 kanë raportuar 190 sipërmarrës. AKEP dëshiron të falenderojë operatorët që kanë depozituar të dhëna për këtë raport dhe shpreson në bashkëpunimin e vazhdueshëm me të gjithë operatorët për procesin e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave statistikore të komunikimeve elektronike në të ardhmen.

AKEP mirëpret sugjerime për të përmirësuar procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave statistikore si dhe të publikimeve të AKEP, me qëllim plotësimin e interesit publik për të krijuar një treg të hapur dhe konkurses të komunikimeve elektronike në Shqipëri, duke ruajtur njëkohësisht konfidencialitetin e të dhënave të publikuar nga AKEP për të shmatur përdorimin e tyre në mënyrë antikonkurrese dhe me praktika tregtare jo të ndershme nga konkurrentët në treg.

Dokumenti në vijim përmban përshkrim të nivelit të treguesve kryesorë në Tremujorin IV 2020 (T4 2020) dhe krahasime me periudhat e mëparshme, dhe më pas paraqiten të dhënat statistikore në formë tabelare për shërbimet nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fikse, të shoqëruara dhe me disa shënime për përshkrimin e treguesve dhe mënyrën e matjes së tyre.

II. Tendencat kryesore

- Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T4 2020 ishte rreth 3,337,824 që përbën një rënie me 2.8% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, dhe një rënie me 1.2% në krahasim me T4 2019;
- Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë T4 2020 arriti në rreth 2.51 milionë që përbën një rritje me rreth 2.8% me T3 2020 dhe mbetet në të njëjtat vlera me T4 2019;
- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T4 2020 ishte rreth 1.99 milionë që përbën një rritje me 2.2% me tremujorin e mëparshëm, dhe një rritje me 11.7% në krahasim me Tremujorin e katërt 2019.
- Totali thirrjeve dalëse të gjeneruara nga pajtimtarët celularë në Shqipëri në T4 2020 ishte rreth 1.4 miliardë minuta, me një rritje prej 2.3% në krahasim me tremujorin paraardhës dhe me një rritje prej 2.7% me T4 2019.
 - o Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) u rrit me 6.9% në krahasim me T3 2020 dhe u rrit me 7.6% në krahasim me një vit më parë në T4 2019;
 - o Sasia e thirrjeve on-net u ul me 0.9% në krahasim me T3 2020 dhe pësoi një rënie me 0.5% në krahasim me T4 2019.
 - o Proporcioni i thirrjeve on-net/off-net në T4 2020 ishte 55%/43%, kundrejt 57%/41% në T4 2019.
- Numri i mesazheve SMS të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në T4 2020 ishte rreth 152 milion që përbën një rënie me 8.7% krahasuar me T3 2020 dhe një rënie me 37.4% me T4 2019;
- Sasia e trafikut data (Internet) në rrjetet celulare gjatë T4 2020 ishte rreth 26 Milion GByte. Një përdorues aktiv i aksesit broadband celular ka përdorur mesatarisht rreth 4.46 GB Internet në muaj në T4 2020, që përbën një rritje me 12.5% në krahasim me T3 2020 dhe një rritje me 29.4% krahasuar me T4 2019.
- Konsumi mesatar mujor për përdorues aktiv i shërbimeve celulare gjatë T4 2020 ishte: 186 minuta dalëse, 20 SMS dhe 4.46 GB Internet. Krahasuar me T3 2020, konsumi mesatar i thirrjeve pati një rënie me 0.5%, konsumi mesatar i SMS-ve pati një rënie me 11.2% dhe konsumi mesatar i internetit u rrit me 12.5%.

Shërbimet nga rrjetet fikse

1. Numri i pajtimtarëve të linjave të telefonisë fikse në fund të tremujorit të katërt 2020 është raportuar rreth 223 mijë, që përbën një rënie me 2.9% në krahasim me T3 2020 dhe një rënie me 8% në krahasim me T4 2019. AKEP ka kryer vlerësimin e këtij treguesi për periudhat para T4 2016 për shkak të ndryshimit të përkufizimit të tij në këtë tremujor (për më shumë detaje shiko shënimet në seksionin 4).
2. Numri i pajtimtarëve me akses Broadband në internet nga rrjete fikse në T4 2020 arriti në rreth 497 mijë, që përbën një rritje me 2.3% në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe një rritje me rreth 14% në krahasim me të njëtin tremujor në vitin 2019.
3. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni/Internet/TV) në fund të 3 muajorit të katërt 2020 arriti në rreth 292 mijë, një rritje kjo me 4.1% në krahasim me T3 2020 dhe rritje me 6.8% krahasuar me T4 2019.
4. Numri i pajtimtarëve me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV) përbën 35.3% të totalit të pajtimtarëve me paketa të integruara ndërsa 30.7% janë me paketa “Internet dhe Telefoni” dhe 30.5% me paketa “Internet dhe TV”.
5. 59% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse në fund të T4 2020 ishin pajtimtarë me paketa të integruara (Telefoni/Internet/TV), ku 21% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

III. Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet celulare

Tabela 3.1 : Numri i pajtimtarëve/përdoruesve celularë sipas kategorive

	Numri i pajtimtarëve shërbime celulare	Përdorues aktivë shërbime celulare	Përdorues aktivë Telefoni Celulare	Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim	Përdorues aktivë me akses broadband celular	Përdorues me akses broadband telefoni celulare	Përdorues me akses broadband me karta të dedikuara
2017	5,558,492	3,625,699	3,460,171	92.0%	2,030,978	1,903,229	127,749
2018	4,143,603	2,714,878	2,570,692	90.0%	1,809,996	1,690,669	119,327
2019 T4	3,378,886	2,630,076	2,515,934	80.9%	1,789,158	1,675,016	114,142
2020 T1	3,257,057	2,588,966	2,481,097	78.3%	1,735,277	1,627,408	107,869
2020 T2	3,163,837	2,371,590	2,267,810	77.4%	1,562,922	1,459,142	103,780
2020 T3	3,434,770	2,551,769	2,445,960	78.2%	1,955,979	1,850,170	105,809
2020 T4	3,337,824	2,618,880	2,514,784	77.3%	1,998,579	1,894,483	104,096
Ndryshimi tremujor	-2.8%	2.6%	2.8%	-1.2%	2.2%	2.4%	-1.6%
Ndryshim v-m-v	-1.2%	-0.4%	0.0%	-4.4%	11.7%	13.1%	-8.8%

Shënime:

Treguesi	Referenca ne Formulare/Menyrat e llogaritjes	Pershkrim/Sqarim
Numri i pajtimtarëve shërbime celulare (karta SIM)	D.10	Numri total i kartave SIM me parapagim dhe pas-pagim që janë aktivë në rrjetin celular në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse kanë kryer komunikim apo jo gjatë periudhës së raportimit. Treguesi përfshin të gjitha kartat SIM që perdoren për shërbime zanore dhe të dhenash, të instaluar në aparate celulare, modem, USB apo pajisje të tjera. Nuk përfshihen kartat M2M. <i>Për periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP si shumë e numrit total të pajtimtarëve të shërbimeve telefonike celulare + numri i përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara.</i>
Përdorues aktive Shërbime Celulare	D.7	Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim në 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celulare me karta SIM dhe karta të dedikuara të dhenash (Data Card). <i>Per periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP si shumë e numrit total të përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celulare + numri i përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara.</i>
Përdorues aktive Telefoni Celulare	D.7-D.10.2	Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celulare në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim në 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celulare me karta SIM telefonike. Nuk përfshihen Data Card. <i>Për T4 2016 dhe T2 2017, treguesi është llogaritur nga AKEP si diferenca e D7 me numrin e përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara (D.10.2).</i>

Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim	D.7.1/D.7	Numri i përdoruesve aktivë (përdorim në tre muajt e fundit) që përdorin karta rimbushëse për përdorimin e shërbimit celular pjestuar me nurmin total të përdoruesve aktivë (D7.1/D7). <i>Për periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP bazuar në numrin e përdoruesve aktivë të telefonisë celulare.</i>
Përdorues active të Akses Broadband Celular	D.10	Numri i pajtimtarëve në rrjetet celulare që kanë përdorur aksesin në Internet me shpejtësi broadband mbi 256 kbps (3G/4G ose me të avancuar) të paktën një herë gjatë periudhës së raportimit. Ky tregues ka kategorinë e përdorimit sipas aparatit telefonik celular, tableta etj me karta SIM (zanore dhe të dhëna) dhe nëpërmjet aksesit me karta SIM të dedikuara për të dhëna (USB, dongles etj).
Përdorues akses broadband celular dhe telefoni celulare	D.10.1	Numri i pajtimtarëve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin në Internet në rrjet 3G/4G ose më të avancuar nëpërmjet kartave SIM të telefonit celular.
Përdorues akses broadband me karta te dedikuara (Data Card)	D.10.2	Numri i pajtimtarëve të rrjetit që kanë përdorur aksesin në internet, në rrjet 3G/4G ose më të avancuar, nëpërmjet kartave të dedikuara për të dhëna (DATA CARD të dedikuara)

Tabela 3.2: Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) sipas operatorëve

Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communication
2017	5,558,492	1,791,473	2,733,771	780,781	252,467
2018	4,143,603	1,428,196	2,086,535	628,872	
2019 T4	3,378,886	1,100,192	1,698,855	579,839	
2020 T1	3,257,057	1,069,703	1,617,835	569,519	
2020 T2	3,163,837	1,062,775	1,547,961	553,101	
2020 T3	3,434,770	1,184,813	1,722,683	527,274	
2020 T4	3,337,824	1,231,169	1,571,022	535,633	
Ndryshimi tremujor	-2.8%	3.9%	-8.8%	1.6%	
Ndryshim v-m-v	-1.2%	11.9%	-7.5%	-7.6%	

Tabela 3.3: Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare sipas operatorëve

Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communication
2017	3,625,699	1,234,411	1,726,842	458,656	205,790
2018	2,714,878	1,004,323	1,279,480	431,075	
2019 T4	2,630,076	952,024	1,256,235	421,817	
2020 T1	2,588,966	990,670	1,187,836	410,460	
2020 T2	2,371,590	849,594	1,133,063	388,933	
2020 T3	2,551,769	928,253	1,211,520	411,996	
2020 T4	2,618,880	967,807	1,229,632	421,441	
Ndryshimi tremujor	2.6%	4.3%	1.5%	2.3%	
Ndryshim v-m-v	-0.4%	1.7%	-2.1%	-0.1%	

TABELA 3.3/1: Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim të shërbimeve celulare sipas operatorëve

Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communication
2017	92.078	90.151	95.190	84.569	94.269
2018	89.661	88.172	93.331	82.233	
2019 T4	80.992	88.435	75.984	79.108	
2020 T1	78.351	87.395	70.883	78.137	
2020 T2	77.440	84.389	72.460	76.765	
2020 T3	78.235	84.298	73.678	77.978	
2020 T4	77.343	82.615	72.886	78.242	
Ndryshimi tremujor	-0.892	-1.683	-0.792	0.264	
Ndryshim v-m-v	-3.649	-5.820	-3.098	-0.866	

Tabela 3.4: Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve

Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communication
2017	3,460,171	1,131,714	1,672,914	449,753	205,790
2018	2,570,692	903,274	1,242,193	425,225	
2019 T4	2,515,934	852,124	1,246,749	417,061	
2020 T1	2,481,097	894,032	1,180,969	406,096	
2020 T2	2,267,810	757,423	1,125,688	384,699	
2020 T3	2,445,960	832,176	1,206,012	407,772	
2020 T4	2,514,784	873,499	1,224,414	416,871	
Ndryshimi tremujor	2.8%	5.0%	1.5%	2.2%	
Ndryshim v-m-v	0.0%	2.5%	-1.8%	0.0%	

Tabela 3.5: Numri i përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve

Numri përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communication
2017	2,030,978	613,886	1,030,614	282,077	104,401
2018	1,809,996	605,984	931,730	272,282	
2019 T4	1,789,158	567,572	940,849	280,737	
2020 T1	1,735,277	581,411	878,147	275,719	
2020 T2	1,562,922	555,474	755,118	252,330	
2020 T3	1,955,979	690,969	984,700	280,310	
2020 T4	1,998,579	718,631	981,483	298,465	
Ndryshimi tremujor	2.2%	4.0%	-0.3%	6.5%	
Ndryshim v-m-v	11.7%	26.6%	4.3%	6.3%	

Tabela 3.6: Volumi total i thirrjeve, SMS-ve, të dhëna dhe përdorimi mesatar mujor

	Totali i thirrjeve telefonike dalese	SMS të dërguara	Trafiku të dhëna (Gbyte)	Minuta në muaj për përdorues	SMS në muaj për përdorues	GB në muaj për përdorues
2017	6,619,674,715	1,400,142,526	45,901,117	638	135	7.53
2018	6,081,651,820	1,212,559,068	60,051,808	789	157	11.06
2019 T4	1,367,452,106	244,268,486	18,494,407	181	32	3.45
2020 T1	1,276,115,523	199,290,094	20,153,941	171	27	3.87
2020 T2	1,268,117,334	138,508,577	18,796,314	186	20	4.01
2020 T3	1,372,526,318	167,406,166	23,266,973	187	23	3.97
2020 T4	1,404,534,150	152,921,400	26,733,607	186	20	4.46
Ndryshimi tremujor	2.3%	-8.7%	14.9%	-0.5%	-11.2%	12.5%
Ndryshim v-m-v	2.7%	-37.4%	44.5%	2.8%	-37.4%	29.4%

Shënime:

Treguesi	Referenca në Formulare/Mënyra e llogaritjes	Përshkrim/Sqarim
Thirrje telefonike dalëse	D.11	Thirrje telefonike dalëse të kryera nga pajtimtarët e rrjeteve celulare gjatë periudhës së raportimit. Trafiku i përfshirë në pagesa fikse llogarit minutat e kryera (reale) dhe jo vlerat nominale të ofertave/shportave. Ky tregues nuk përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - Trafikun e pajtimtrëve të rrjeteve celulare Shqiptare gjatë kohës që ata janë në roaming ndërkombëtar. - Trafikun e pajtimtarëve të rrjeteve të huaja gjatë kohës që ata janë në roaming në rrjetet celulare Shqiptare.
SMS të dërguara	D.13	Numri total i SMS-ve të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare drejt të gjitha destinacioneve, përfshirë SMS ndërkombëtare
Trafiku të dhëna (GByte)	D.14	I referohet sasisë së trafikut broadband të origjinuar brenda Shqipërisë nga rrjetet celulare 3G/4G ose me të avancuara. Trafiku përfshin shkarkimet dhe ngarkimet (doëload dhe upload) i matur në pikat e aksesit të përdoruesit fundor. Nuk përfshihet trafiku me shumicë dhe 'èalled garden'. <i>Në bazë tërenujore ky tregues është i dëpsonueshëm vetëm për T4 2016, T12017 e në vijim. Më parë është raportuar vetëm në bazë vjetore.</i>
Minuta në muaj për përdorues	D.11/(D.7-D.10.2)/3	Numri i minutave të thirrjeve dalëse që një përdorues aktiv i shërbimeve telefonike celulare ka gjeneruar mesatarisht në një muaj. Llogaritet si raporti i trafikut total dalës (D7) me numrin e përdoruesve aktive të telefonisë celulare (D.7-D.10.2) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktivë në fillim dhe në fund të periudhës.
GB në muaj për përdorues	D.14/D.10/3	Sasia GB e trafikut të Internetit që një përdorues aktiv i shërbimeve akses broadband celular ka përdorur mesatarisht në një muaj. Llogaritet si raporti i trafikut total të të dhënave (D14) me numrin e përdoruesve aktive të aksesit broadband celular (D.10) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktivë në fillim dhe në fund të periudhës.

Tabela 3.7: Struktura e thirrjeve dalëse celulare të origjinuar brenda vendit sipa destinacionit

Struktura e thirrjeve dalëse celulare	Total	On-net	Off-net	Fiks kombëtar	Ndërkombëtare	Të tjera
2017	6,619,674,715	3,584,057,628	2,862,342,921	69,709,617	100,533,071	3,031,478
2018	6,081,651,819	3,451,495,389	2,501,186,119	66,324,565	60,043,298	2,602,449
2019 T4	1,367,452,106	774,795,545	567,358,568	14,645,415	10,004,161	648,418
2020 T1	1,276,115,523	724,332,921	528,361,187	13,918,545	9,073,991	1,057,164
2020 T2	1,268,117,334	709,002,349	536,095,840	15,272,479	6,581,069	1,165,598
2020 T3	1,372,526,318	778,186,536	571,088,783	14,449,527	7,917,082	884,389
2020 T4	1,404,534,150	770,868,447	610,288,356	14,495,209	7,945,518	936,619
Ndryshimi tremujor	2.3%	-0.9%	6.9%	0.3%	0.4%	5.9%
Ndryshim v-m-v	2.7%	-0.5%	7.6%	-1.0%	-20.6%	44.4%

IV. Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet fikse

Tabela 4.1 : Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse

Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	Totali	Albtelecom	ASC	Abcom	Abissnet	Nisatel	OA të tjerë	Pjese tregu Albtelecom
2017	246,720	171,516	42,829	15,282	3,982	2,470	10,641	69.5%
2018	248,631	177,129	40,377	11,637	4,049	4,100	11,339	71.2%
2019 T4	243,255	176,653	35,558	11,409	4,095	4,098	11,442	72.6%
2020 T1	238,881	174,661	34,313	10,514	4,080	4,327	10,986	73.1%
2020 T2	236,477	174,062	32,975	9,612	4,136	4,209	11,483	73.6%
2020 T3	230,593	171,029	31,698	8,956	4,149	4,125	10,636	74.2%
2020 T4	223,739	168,142	30,399	8,524	4,154	4,122	8,398	75.2%
Ndryshimi tremujor	-2.97%	-1.69%	-4.10%	-4.82%	0.12%	-0.07%	-21.04%	1.3%
Ndryshim v-m-v	-8.0%	-4.8%	-14.5%	-25.3%	1.4%	0.6%	-26.6%	3.5%

Tabela 4.2 : Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse

Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse	Totali	Albtelecom	Abcom	ASC	Abissnet	Digicom	Nisatel	OA te tjere	Pjese tregu Albtelecom
2017	303,612	120,204	55,860	46,118	28,633	10,567	7,500	34,730	39.6%
2018	361,947	129,329	64,020	49,359	37,055	14,322	13,473	54,389	35.7%
2019 T4	436,234	133,515	74,708	52,773	40,849	18,516	13,809	102,064	30.6%
2020 T1	444,713	132,850	80,550	53,850	40,853	19,785	14,467	102,358	29.9%
2020 T2	472,450	133,516	86,895	55,304	41,199	20,112	15,117	120,307	28.3%
2020 T3	485,818 ¹	131,433	89,060	56,908	41,417	21,500	16,550	128,950	27.1%
2020 T4	497,126	128,877	95,558	58,529	41,576	22,400	17,609	132,577	25.9%
Ndryshimi tremujor	2.3%	-1.9%	7.3%	2.8%	0.4%	4.2%	6.4%	2.8%	-4.2%
Ndryshim v-m-v	14.0%	-3.5%	27.9%	10.9%	1.8%	21.0%	27.5%	29.9%	-15.3%

¹ Përditësuar të dhënat mbi numrin e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse për T3 2020

Tabela 4.3 : Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara

Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	Totali	Telefoni fikse dhe Internet	Telefoni fikse, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2017	202,344	83,017	100,168	19,159
2018	224,859	91,599	107,176	26,084
2019 T4	274,198	87,180	109,739	77,279
2020 T1	267,627	88,489	107,663	71,475
2020 T2	280,785	89,924	107,535	83,326
2020 T3	281,204 ²	89,643	105,897	85,664
2020 T4	292,751	89,863	103,465	99,423
Ndryshimi tremujor	4.1%	0.2%	-2.3%	16.1%
Ndryshim v-m-v	6.8%	3.1%	-5.7%	28.7%

Shënime:

Treguesi	Referenca ne Formulare/Menyrë e llogaritjes	Pershkrim/Sqarim
Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	A.1	<p>Ky tregues i referohet numrit total të linjave telefonike që pajtimtarët e rrjetit fiks përdorin për shërbim telefonik fiks dhe që plotësojnë dy kushte: 1) pajtimtarit i është alokuar një numer fiks në rrjetin e operatorit (përfshirë numrat e marrë nga operatorët e tjerë me portim), dhe 2) numri fiks i alokuar është në përdorim në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse është kryer apo jo thirrje (dalëse apo hyrëse) gjatë periudhës nga pajtimtari. Pra ky tregues është sasia totale e numrave fiks të alokuar dhe që janë ende në përdorim nga pajtimtarët në fund të periudhës së raportimit. Këtu përfshihen edhe pajtimtarët që kanë të përfshirë shërbimin e telefonisë fikse si pjesë e paketave të integruara së bashku me shërbime të tjera si Internet, TV etj.</p> <p><i>Për periudhën 2014 T4- 2015 T3 ky tregues përfshinte totalin e pajtimtarëve me parapagim të telefonisë fikse (numri i pajtimtarëve aktivë, pra që kanë përdorur shërbimin e telefonisë fikse në 3 muajt e fundit, të paktën një thirrje hyrëse ose dalëse) dhe pajtimtarët me kontratë/paspagim ose me parapagim por që kanë paguar në avancë shërbimin (për tre muajt e fundit) të cilët konsiderohen aktivë.</i></p> <p><i>Për shkak të ndryshimit të përkufizimit në T4 2016, për të mundësuar krahasueshmërinë e vlerave të këtij treguesi në periudha të ndryshme kohore (parimi i rregullores së statistikave në pikën 6.2), AKEP ka kryer vlerësim të këtij treguesi për periudhat para T4 2016 për përfshirje në këtë tregues të të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse, pavarësisht përdorimit aktiv (në 3 muajt e fundit) ose jo, sic ishte përkufizimi në 2014 T4- 2016 T3. Për më shumë shiko shënimin poshtë Tabelës 4.1</i></p>
Numri i pajtimtarëve me	B.1	Përfshin numrin total të pajtimtareve me akses broadband fiks me shpejtësi download 256 kbit/s ose më të madhe. Ky tregues përfshin aksesin në internet me DSL, modem kabllor, fibër në

² Përditësuar të dhënat mbi numrin e pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara për T3 2020

akses broadband nga rrjetet fikse		shtëpi/ndërtese dhe gjithë llojet e tjera të aksesit broadband me rrjet fiks. Nuk përfshihet aksesit broadband me rrjet celular.
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	B.7	Numri total i pajtimtarëve që kanë paketa të përbashkëta (të integruar-bundles) sipas kombinimeve të mëposhtme. Paketa të integruara konsiderohen kur paguajnë një tarifë fikse që përfshin të paktën 2 shërbime: Telefoni, Internet apo TV.
Telefoni fikse dhe Internet	B.7.1	Numri i pajtimtarëve të rrjetit fiks që kanë paketë të përbashkët (dyfishe) telefoni dhe internet (pakete dyfishe), duke paguar një tarifë që përfshin dhe pajtimin mujor për telefoni dhe për akses në Internet broadband. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin telefoni dhe Internet por që kanë tarifa të vecanta mujore për dy shërbimet. Pagesa fikse mund të përfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit.
Telefoni fikse, Internet dhe TV	B.7.2	Numri i pajtimtarëve të rrjetit fiks që kanë paketë të përbashkët (trefishe) telefoni, Internet dhe TV (IPTCV ose TV kabllor), duke paguar një tarifë që përfshin pajtimin mujor për telefoni, akses në Internet broadband dhe kanalet TV. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin tre shërbimet por që kanë tarifa të vecanta mujore për tre shërbimet. Pagesa fikse mund të përfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit, si dhe kur ka pagesë ekstra për kanale TV shtesë mbi kanalet bazë TV.
Internet dhe TV	B.7.3	Pajtimtarë të rrjeteve fikse që kanë vetëm Internet dhe TV, pra jo telefoni fikse.